

ANALIZË E HAPJES
SË **KUVENDIT**
NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

PROPOZIME PËR PËRMIRËSIMIN
E GJENDJES AKTUALE

RRETH PUBLIKIMIT

Ky dokument është zhvilluar në kuadër të projektit 'Boost Good Governance 2.0', i mbështetur nga National Endowment for Democracy (NED), dhe i zbatuar nga Open Data Kosovo (ODK).

AUTORËT

Dafina Olluri dhe Delvina Haxhijaha

VERSIONET GJUHËSORE

ALB, ENG, SRB

Përfunduar në Shkurt, 2022 © ODK

Mendimet e shprehura në këtë dokument janë përgjegjësi vetëm e autorit dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht qëndrimin zyrtar të NED. Riprodhimi dhe përkthimi për qëllime jo komerciale janë të autorizuar, me kusht që të njihet burimi dhe botuesi të njoftohet paraprakisht dhe t'i dërgohet një kopje.

HYRJE

Analizat e zhvilluara nga ODK përgjatë viteve të cilat kanë monitoruar dhe vlerësuar hapjen dhe transparencën e punës së Kuvendit në Kosovë, shpalosin qartazi se transparenca legjislative mund të përmirësojë performancën e parlamentarëve në demokraci. Në një demokraci, nxitja për përmirësimin e performancës krijohet nga komunikimi dhe bashkëpunimi i vazhdueshëm me qytetarët. Andaj dhe kjo analizë është përpiluar me qëllim të evidentoj nivelin e transparencës, hapjes institucionale, hapjes dhe përgjegjësisë së Kuvendit në Kosovë përgjatë vitit 2020.

Duke përdorur praktikën e Analizës së zhvilluar për Hapjen e Kuvendit të Kosovës përgjatë vitit 2019 analiza e propozimit të politikave praktike edhe kësaj here është rezultat i një hulumtimi të gjerë të bazuar në metodologjinë shkencore të kryer nga Open Data Kosova në muajt e fundit. Qëllimi i këtij hulumtimi gjithpërfshirës është të sigurojë një pasqyrë të detajuar të situatës në Kosovë dhe të kontribuojë në zbatimin e reformës së administratës publike. Ky punim gjithashtu synon të forcojë parimet e qeverisjes së mirë dhe të ndihmojë institucionet t'i zbatojnë ato në mënyrë më efektive në punën e tyre.

Pas një vlerësimi të qëllimit të propozuar në vitin e kaluar, respektivisht në 2019, ky punim paraqet analizën e nivelit të hapjes dhe rekomandimet për përmirësim për vitin 2020. Metodologjia dhe treguesit e saj janë përmirësuar vazhdimisht dhe i janë përshtatur kërkesave të vitit përkatës. Ky dokument i politikave sjell gjithashtu një element krahasues ku ODK-ja ka hartuar një analizë duke përfshirë progresin e treguar përgjatë dy viteve të fundit. Hapja institucionale duhet të jetë politika e të gjitha qeverive në rajon dhe duhet të formulohet dhe trajtohet në mënyrë të barabartë si politikat e tjera të rëndësishme. Një politikë e tillë duhet të ruajë objektivitetin e saj në këtë çështje dhe nuk duhet të ndikohet në asnjë rast nga vendimet aktuale politike ose elemente tjera politike.

Ky dokument i propozimit të politikave i drejtohet Kuvendit dhe vendimmarrësve të cilët mund të përfitojnë nga ky dokument nëse rezultatet dhe rekomandimet e tij merren parasysh me kujdes. Dokumenti mund të jetë i dobishëm edhe për përfaqësuesit e organizatave ndërkombëtare, si dhe kolegëve nga sektori i OJQ-ve që merren me këto çështje.

ODK-ja ka respektuar parimet e transparencës së hulumtimit dhe ka prezantuar tek institucionet të gjitha detajet dhe rezultatet e tij. ODK-ja mbetet e hapur për çdo sugjerim, kritikë konstruktive dhe diskutim në lidhje me dokumentin e politikave.

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Kjo analizë përcolli shkallën e marrjes së informacioneve nga Indeksi Rajonal i Hapjes i cili mat se deri në çfarë mase janë institucionet e vendeve të Ballkanit Perëndimor të hapura për qytetarët dhe shoqërinë dhe bazohet në katër parimet e mëposhtme:

🔍 **transparenca,**

🗉 **qasshmëria,**

🤝 **integriteti dhe**

🔧 **ndërgjegjësimi.**

Duke ndjekur standardet ndërkombëtare, rekomandimet dhe shembujt e praktikave të mira, këto parime zhvillohen më tej përmes treguesve specifik, sasiorë dhe cilësorë. Parimet e tilla vlerësohen në bazë të: qasjes së informacionit në faqet zyrtare të institucioneve, cilësisë së kornizës ligjore për pyetje specifike, burimeve të tjera të informacionit publik dhe pyetësorëve të dorëzuar në institucione. Një grup rekomandimesh drejtuar institucioneve u zhvillua në bazë të rezultateve të hulumtimit.

Parimi i **transparencës** kërkon që informacioni organizativ, buxheti dhe procedura e prokurimeve publike të jenë në dispozicion të publikut dhe të publikohen dhe përditësohen rregullisht. **Qasshmëria** lidhet me sigurimin dhe respektimin e procedurave për një qasje të lirë në informacion, përmirësimin e disponueshmërisë së informacionit përmes debateve publike dhe forcimin e ndërveprimit me qytetarët. **Integriteti** përfshin elementet e parandalimit të korrupsionit, kryerjen e kodit të etikës dhe rregullimin e lobimit. Parimi i fundit, **ndërgjegjësimi**, i referohet monitorimit dhe vlerësimit të politikave të kryera nga institucionet.


Disponueshmëria e informacionit mbi politikat dhe veprimet e qeverisë, një ndjenjë e qartë e përgjegjësisë organizative dhe një siguri se qeveritë administrohen në mënyrë efikase dhe pa korrupsion sistemik janë komponente të rëndësishme të qeverisjes transparente. Andaj, edhe të gjitha katër nga principet e lartpërmendura si pjesë e Indeksit Rajonal të Hapjes asistojnë në përcaktimin, paraqitjen, dhe vlerësimin e punës dhe vullnetit të mirë politik drejt transparencës.

HAPJA E KUVENDIT NË VITIN 2019

Kuvendi i i Kosovës shënoi një rezultat të përgjithshëm prej 80,5% në aspektin e hapjes për vitin 2019. Një rezultat i tillë tregon një përmirësim të madh të këtij institucioni përgjatë viteve. Meqenëse ka gjithnjë hapësirë për përmirësim, ky rezultat tregon se Kuvendi ka rritur hapjen e tij me kalimin e viteve. Nëse do të krahasonim një rezultat të tillë në një kontekst rajonal, Kuvendi i Kosovës ka shumë për të bërë në aspektin e hapjes së tij, megjithatë, në kontekstin kombëtar një përmirësim i tillë është i kënaqshëm. Rezultatet e indeksit u arritën duke marrë parasysh katër Parimet për Hapjen e Kuvendit të cilat përfshijnë: transparencën, qasshmërinë, integritetin dhe ndërgjegjësimin. Në pjesën vijuese, do të ketë një shpjegim të hollësishëm të parimeve kryesore dhe rezultatit të Kuvendit në fushat e lartpërmendura.

HAPJA E KUVENDIT NË VITIN 2020

Kur u mat për herë të parë në vitin 2016, Kuvendi i Kosovës shënoi 60% në tregues, ndërsa tani rezultati tregon përmirësim për shkak të përpjekjeve të bëra ndër vite - gjegjësisht shënoi një rezultat të përgjithshëm prej 88% në aspektin e hapjes për vitin 2020. Kuvendi i Kosovës shënoi 72% në parimin e qasshmërisë, 91% në komponentën e ndërgjegjësimit, 100% në parimin e integritetit dhe 91% në parimin e transparencës. Në pjesën vijuese, do të ketë një shpjegim të hollësishëm të parimeve kryesore dhe rezultatit të Kuvendit në fushat e lartpërmendura.



QASSHMËRIA (72%)

Duke krahasuar me gjetjet e vitit 2019, Kuvendi i Kosovës ka shënuar përmirësim në parimin e Qasshmërisë, gjithsesi ka ende punë për tu bërë në ngritjen dhe përmirësimin e kësaj komponente në të ardhmen. Ky komponent vlerëson shkallën e pjesëmarrjes së qytetarëve, OShC-ve, e akterëve në punën e Kuvendit, duke përfshirë por pa u kufizuar në Aktin e Lirisë së Informacionit dhe rregulloreve të tjera ekzistuese.

Në teori, konsultimi publik ofron një mundësi për interesat e një grupi më divers të publikut që të kenë qasje në pushtetin politik dhe të marrin pjesë në ushtrimin e tij. Aktualisht, në faqen zyrtare të Kuvendit të Kosovës palëve të interesuara u mundësohet dërgimi direkt i shkresave tek deputeti/deputetja e përzjedhur për të adresuar ndonjë çështje specifike dhe me interes për palën. Gjithashtu, ODK është duke vazhduar bashkëpunimin me Kuvendin e Kosovës për të zhvilluar zgjidhjen digjitale E-pjesëmarrja e cila do të mundësojë komunikim të drejtpërdrejtë mes publikut të gjerë dhe deputetëve. Edhe gjatë këtij viti, Kuvendi i Kosovës është aktiv në përditësimin e uebfaqes dhe faqeve në rrejte sociale të Institucionit, duke publikuar njoftime rreth vendimeve, aktiviteteve dhe punës së Kuvendit. Vlen të theksohet se Kuvendi vazhdon të ketë të caktuar personin përgjegjës për trajtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike i cili kalon një kohë të arsyeshme duke iu përgjigjur kërkesave – siç parashikohet edhe në Ligjin për Qasje në Dokumente Publike.

Gjatë këtij viti vlerësimi, është caktuar Komisionerja për Informim dhe Privatësi në kuadër të Agjencisë së Informacionit dhe Privatësisë, ku deri para përzgjedhjes së Komisioneres pozita aktuale më e lartë ka qenë ajo e drejtorit ekzekutiv. Kjo Agjenci është përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike dhe Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, dhe në pajtim me këtë ligj dhe i përgjigjet Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Gjithsesi, edhe kësaj rradhe është vlerësuar si e rëndësishme ofrimi dhe zhvillimi i më shumë trajnimeve për stafin e Kuvendit sa i përket rëndësisë dhe ofrimit të qasjes së informatave publike. Sipas sondazhit të plotësuar nga përfaqësuesit e Kuvendin të Kosovës, stafi i Kuvendit të Kosovës ka marrë pjesë në disa sesione trajnuese. Sipas ligjit për Qasje në Dokumente Publike, Agjencia për Informim dhe Privatësi duhet të bashkëpunojë me institucionet përgjegjëse për organizimin dhe mbajtjen e trajnimeve për zyrtarët publikë për qasje në dokumente publike dhe për zbatimin efektiv të këtij ligji.


Ajo që aktualisht mungon në pjesëmarrjen dhe angazhimin e qytetarëve në Kosovë e cila do të rrisë drejtpërdrejt përdorimin është miratimi i Peticionit elektronik me Kuvendin e Kosovës. Një fushë e tillë është thelbësore për rritjen e rolit të hapjes brenda parlamentit dhe përket në komponentin e qasjes. Për të zhvilluar peticionin elektronik, duhet miratuar ligji për peticione elektronike i cili do të merrej edhe me privatësinë e të dhënave dhe çështje të tjera. Kërkesa elektronike do të rrisë numrin e individëve dhe të tjerët bëjnë iniciimin e peticionit pa qenë e nevojshme të mbledhin nënshkrime në “rrugë”. Kjo është arsyeja pse, Kosova edhe gjatë këtij viti vlerësimi ka shënuar zero pik në tre treguesit që lidhen me peticionin elektronik. Mirëpo peticioni elektronik vazhdon të mbetet një fushë premtuese për sa i përket hapjes institucionale, pjesëmarrjes dhe angazhimit qytetar.

Kuvendi i Kosovës vazhdon të mbajë një marrëdhënie të mirë me shoqërinë civile siç parashikohet edhe nga rregulloret e punës në komisionet parlamentare (Rregullorja e Punës, neni 65). Grupi joformal për Transparencën dhe Përgjegjësinë në Kuvendi vazhdon me angazhimin e tij në drejtim të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies në Kuvend, duke punuar me OShC-të deputetët, zyrtarët publik, organizatat ndërkombëtare dhe qytetarë në këtë proces.

NDËRGJEGJËSIMI (91%)

Komponenta e Ndërgjegjësimit është njëra nga komponentet e cila ka vazhduar të shënoj rritje të dukshme për këtë vit vlerësim. Sipas matjes të kësaj periudhe, ekzistojnë disa mekanizma të vlerësimit të ndikimit rregullator (RIA), mirëpo që rrallë herë aplikohet në punën e Kuvendit dhe rregulloreve të hartuara. Pra, sa i përket planifikimit strategjik, Kuvendi ka pasur zhvillime duke qenë se vlerëson ndikimet që mund të vijnë si rezultat i akteve ligjore ekzistuese dhe të përgatitura për përmirësim dhe lehtësim të punës.

Gjithashtu, vlen të theksohet se Komisionet Parlamentare kanë vazhduar të marrin vlerësime dhe konsultime nga ekspertë të jashtëm për tema specifike me qëllim të marrjes së udhëzimeve dhe informacioneve për çështje me interes. Poashtu ka vazhduar ofrimi i pjesëmarrjes së ekspertëve në fjalë në seanca dëgjimore publike – duke bërë kështu që qytetarët të jenë të ndërgjegjshëm për zhvillimet që ndikojnë jetën e tyre përballë punës së Kuvendit.



E rëndësishme të theksohet se si pjesë e nënsektorit të monitorimit parlamentar, përfaqësuesit e Kryesisë Ekzekutive vazhdojnë të jenë të përgjegjshëm në pjesëmarrje dhe mund të sillen në Kuvend për t'u përgjigjur pyetjeve të deputetëve. Tutje, ekziston procedura për zhvillimin e Mocionit të Mosbesimit, si dhe grupet parlamentare ose deputetët gjithashtu mund të paraqesin peticione për interpelancë për të shqyrtuar çështje që ndërlidhen me punën e qeverisë ose të një ministrie. Gjithashtu, aktivitetet parlamentare dhe dëgjimet regjistrohen në shumicën e rasteve, të cilat janë të hapura për publikun dhe mbesin të arkivuara. Kjo njëherit përmbush kërkesat e parimit të ndërgjegjësimit, duke bërë që palët e interesuara të jenë të njoftuar dhe të ndërgjegjshëm rreth punës së Kuvendit.

INTEGRITETI (100%)

Suksesi më i lartë në matjen e këtij viti vlerësimi është arritur në komponentën e Integritetit, ku Kuvendi i Kosovës ka shënuar 100%. Ky komponent ndërthurë principet dhe rregulloret për parandalimin e korrupsionit, zbatimin e kodit të etikës dhe integritetit në proceset e lobimit.

Duhet theksojmë se Kosova është një nga vendet e pakta që publikon plotësisht pronat, pasurinë, të ardhurat dhe borxhet e rreth 5000 zyrtarëve publikë të vendit që deklarojnë pasurinë. Andaj, edhe informatat mbi asetet, burimet e të ardhurave, shumën e të ardhurave dhe detyrimet përditësohen dhe listohen në listen e aseteve të anëtarëve të Kuvendit. Këto të dhëna sistemohen dhe arkivohen në mënyrë që të jenë lehtësisht të arritshme nga palët e interesuara dhe publiku i gjerë nga Agjencia Kundër Korrupsionit. Kjo Agjenci bën monitorimin e zbatimit të listave të aseteve. Sidoqoftë, sipas Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, dhe Ligjit për Mbrojtjen e të dhënave personale, të dhënat mbi deklarimin e pasurisë mund të sigurohen me anë të kërkesës për qasje.

Siç edhe u permend më lartë, Agjencia Kundër Korrupsionit, është organi kompetent dhe angazhohet vazhdimisht në monitorimin e aseteve të zyrtarëve publik. Agjencia poashtu mbikëqyr pranimin e dhuratave që kanë të bëjnë me kryerjen e detyrës zyrtare dhe ndërmerr masat e parapara me ligj. Në rast të shkeljeve të detyrimeve të parashikuara me ligj nga deputetët, Agjencia paraqet kallëzim penal në prokurorinë kompetente.

Tutje, kur flasim për integritetin në punën e Kuvendit të Kosovës, padyshim se rol të madh luan zbatimi i Kodit të Etikës për Anëtarët e Kuvendit si një mjet efektiv për zbutjen dhe parandalimin e korrupsionit në vend. Kodi në fjalë është pjesë e Rregullorës së Punës së Kuvendit, si dhe është lehtësisht i qasshëm në uebfaqen e Kuvendit.



Ky kod përmbledh dhe rregullon çështjet e përdorimit të pronës shtetërore, dhuratave, konfliktit të interesit dhe veprimtarisë politike. Ndërsa, Ligji për të drejtat dhe Përgjegjësite e Deputetit, ndër të tjera, rregullon edhe Kodin e Etikës dhe Konfliktin e Interesave për Anëtarët e Kuvendit.

Kur vlerësohet nënkomponenta e Lobimit, në Kosovë ende nuk ekziston një rregullore e cila shpalos dhe definon rregullat e lobimit – si pjesë e komunikimit direkt apo indirekt me zyrtarë publik, vendimmarrës politik apo përfaqësues të tjerë, e që ndërlidhen me imazhin e vendit si tërësi. Në vitet e fundit, lobimi është bërë një fushë e rregullimit në rritje, që ka prioritet kuptimin se kush në veçanti lobon. Vendosja e rregullave të qarta për lobim është hap i rëndësishëm në forcimin e transparencës dhe kornizës ligjore për luftimin e korrupsionit. Rregullat njëherit do të përcaktonin aktivitetet legjitime lobiste duke i dalluar ato që vijnë nga shoqëria civile apo palë të tjera interesi.

TRANSPARENCA (91%)

Parimi i transparencës së Kuvendit të Kosovës ka shënuar rritje në 91% prej 88% sa ishte në monitorimin e kaluar. Ky parim përfshinë hapjen dhe publikimin e çdo lloj informacioni organizativ, buxhetit dhe proceset e prokurimit publik në uebfaqen zyrtare të internetit. Faqja zyrtare e internetit e Kuvendit ofron qasje të lehtë në ligje, ndryshime, projekt legjislacion, rregullore, strategji dhe raporte të punës. Ajo çka poashtu kontribuon në transparencën e Kuvendit është Sistemi për Përcjellje të Legjislacionit i cili u mundëson qytetarëve dhe palëve të tjera të interesit të përfshihen më shumë në procesin legjislativ pasi ata mund të përcjellin se në cilën fazë është ligji me interes për ta. Të dhënat e votimit nga seancat plenare të Kuvendit publikohen gjithashtu në faqen e internetit. Gjithashtu, Kuvendi ka transmetim në video të seancave plenare, të cilat në tërësi inkurajojnë pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në procesin legjislativ, duke forcuar kështu rolin e Kuvendit si institucion.

Kur shikohet nënkomponenta e informacionit organizativ, është vlerësuar lartë nënshkrimi i deklaratës së Hapjes së Kuvendit, ku në përputhje me deklaratën, Kuvendi ka zhvilluar strategjinë për informim dhe Komunikim në Kuvend (2019-2021). Poashtu, të gjitha të dhënat sa i përket Komiteteve në kuadër të Kuvendit, deputetët e angazhuar, seancat dëgjimore etj., janë vazhdimisht të publikuara në uebfaqen e Kuvendit. Tutje, një nga dokumentet më të rëndësishme që Kuvendi ka miratuar është rregullorja për komunikim me media dhe publikun duke vendosur kështu rregulla dhe procedura për stafin, si dhe palët e treta që ndjekin punën e kuvendit për të siguruar komunikimi të duhur dhe efektiv.

Sa i përket transparencës në prokurimin publik, Kuvendi i Kosovës vazhdon të mbajë nivelin e transparencës në shkallë të duhura. Kjo, duke publikuar procedurat e prokurimit publik, ofertat dhe rezultatet kryesore të prokurimit përmes portalit shtetëror për prokurimin publik siç parashikohet edhe me ligj. Poashtu, Kuvendi i Kosovës ka publikuar me sukses planin përfundimtar të prokurimit, i cili mund të jetë i qasshëm nga qytetarët e Kosovës.

Kuvendi i Kosovës publikon buxhetin në uebfaqe, duke ofruar edhe raporte financiare më të detajuara në baza tremujore dhe vjetore mbi shpenzimet e Institucionit. Edhe përgjatë këtij viti vlerësimi, këto të dhëna janë publikua në formate lehtësisht të qasshme dhe të kuptueshme, duke përforcuar infrastrukturën e dhënies së informacionit në formate të duhura për publikun dhe palët e interesuara.

Edhe gjatë këtij viti vlerësimi, mbetet për tu dëshiruar botimi i të ashtuquajturit buxhet i qytetarit, buxhet i cili rekomandohet të botohet në një format të lehtë për përdorim dhe të kuptueshëm për qytetarët e zakonshëm. Ky botim do të ndihmonte në rritjen e transparencës së Kuvendit të Kosovës për sa i përket Buxhetit të Shtetit, si dhe do të kontribuonte në rritjen e transparencës fiskale.

ANGAZHIMI I QYTETARËVE NË PUNËN E KUVENDIT NË KOSOVË

ODK ka vazhduar bashkëpunimin me UBO Consulting duke hulumtuar angazhimin e qytetarëve në punën e Kuvendit të Kosovës. Gjithsej 1065 qytetarë të Republikës së Kosovës janë intervistuar përmes metodës së mostrës gjithëpërfshirëse, të grupuar sipas moshës, gjinisë, përkatësisë etnike, vendbanimit dhe të ardhurave familjare.

Nga anketat e zhvilluara, shumica e të anketuarve kanë theksuar se e përcjellin pak punën e Kuvendit, me 46.4% të femrave dhe 38.3% të meshkujve. Tutje, 26.1% e femrave dhe 37.5% e meshkujve janë shprehur të përcjellin deri diku punën e Kuvendit, kurse 4.1% e femrave dhe 7.9% e meshkujve thanë se e përcjellin shumë. Këto gjetje mund të nënkuptojnë se qytetarët nuk janë të interesuar të informohen më shumë për punën e Kuvendit të Kosovës, ose se puna e Kuvendit nuk arrin të sigurohet në një format të kuptueshëm dhe të arritshëm.

Pyetja vijuese e cila u adresua ishte kënaqësia e të anketuarve me punën e Kuvendit të Kosovës. Në përgjithësi, është konstatuar se shumica e individëve janë disi të kënaqur me punën e Kuvendit të Kosovës, me 43.4% të grave dhe 46.3% të burrave që e tregojnë këtë.

Ndërsa, vetëm 2.3% e femrave dhe 1.8% e meshkujve janë shumë të kënaqur me punën e kuvendit. Përçindja më e madhe që kanë shprehur kënaqësinë e tyre neutrale me punën e Kuvendit të Kosovës janë të moshës 35 - 44 vjeçare.

Vlen të theksohet se në pyetjen e fundit drejtuar tek të anketuarit, më shumë se gjysma e të anketuarve nuk mendojnë se mund të kontribuojnë në iniciativat e Kuvendit. Kurse vetëm 36.3% e meshkujve, dhe 27.2% e femrave menduan se mund të kontribuojnë në punën e Institucionit në fjalë. Në anën tjetër 17.8% e meshkujve dhe 12.4% e femrave të anketuar rreth kësaj çështje nuk kishin një mendim të caktuar. Nga këto rezultate duhet theksuar se është me rëndësi përfshierja e bindjeve të qytetarëve në punën e Kuvendit, dhe andaj duhet gjetur dhe punuar në zhvillimin e formave të cilat arrijnë tek qytetari – kështu duke mundësuar dhe llogaritur inputin e qytetarit në punën e Institucionit në fjalë.



REKOMANDIME

HAPAT E VEPRIMIT

Nga rekomandimet e matjes së kaluar, është lajm i mirë arritja e njërit nga rekomandimet e popozuara e që ishte zgjedhja e Komisionerës për Informim dhe Privatësi për Agjencinë përkatëse. Andaj, edhe në këtë vit vlerësimi, në mënyrë që të vazhdohet puna me rezultate të larta, ne rekomandojmë që Kuvendi i Kosovës të ndërmarrë hapat e mëposhtëm:

- **Të kalojë legjislacionin e nënshkrimit elektronik (e-signature);**
- **Të fillojë zbatimin e sistemit të petitionit elektronik (e-petitioning);**
- **Të zbatojë mekanizma të vlerësimit të ndikimit rregullator (RIA) në mënyrë që të sigurojë një vlerësim të hollësishëm dhe sistematik të ndikimeve të mundshme të një rregulloreje të re për të vlerësuar më pas plotësimin dhe arritjen e objektivave të dëshiruar të rregullores;**
- **Të avancojë rregullimin e rregullave të lobimit;**
- **Të publikojë të ashtuquajturin buxhet të qytetarëve, në mënyrë që të rritet transparenca e Kuvendit në komponentën e Buxhetit të Shtetit;**
- **Të organizojë më shumë trajnime për stafin e Kuvendit në fushën e qasjes në dokumente publike.**

